



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

**të mbledhjes së tetë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 28.09.2018,
e cila filloi në orën 10:00.**

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, Shpend Ahmeti, kryetar i Komunës, Selim Pacolli, nënkryetar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Visare Gashi (PSD), Nol Nushi (PSD), Drilon Pireva (PSD), Bashkim Beha (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Adrian Berisha (PSD), Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Eman Rrahmani (LVV), Egzon Azemi (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Valbona Petrovci, e pavarur, Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Sami Salihu (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Milazim Vitija (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Naime Osmani (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Uran Ismaili (PDK), Migjen Shala (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Florida Canolli (PDK), Sokol Berisha (AAK), Yll Bogaj (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Suzan Kika (AAK), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR-AA), Sami Boroci, (AKR-AA), Arbenita Murseli (AKR-AA), Adelina Fazliji (AKR-AA), Rifat Deri (AKR-AA) dhe Bukurie Canolli (LB).

Munguan: Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK) dhe Baton Dushi (Nisma).

Të pranishëm ishin edhe drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të medieve të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të OSBE-së dhe të KFOR-it.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesuesi i Kuvendit.
Ai hapi diskutimin për rendin ditës.

Halim Halimi bëri vërejte, duke thënë se materialet për këtë mbledhje na kanë ardhur me shumë vonesë. Jo vetëm sipas Ligjit për vetëqeverisjen lokale dhe Udhëzimit administrativ, por edhe sipas Statutit, dihet se për mbledhje shtatë ditë përpara u dërgohet ftesa anëtarëve të Kuvendit. Ju lus, që në të ardhmen të mos ketë probleme të tilla, sepse me vetëdije po bëjmë shkelje ligjore.

Tash e shoh se na është sjellë një material shtesë për buxhetin, por ky material do të duhej të sillej me kohë. Duke pasur parasysh këto që i cekta, mendoj se është mirë që kjo mbledhje të shtyhet për javën e ardhshme dhe të përgatitemi mirë.

Kryesuesi tha se problemi është që Kuvendi po mbahet dy ditë pas KPF-së, mirëpo kjo çështje ka ardhur si rezultat i çështjes së trajtimit të buxhetit të Kuvendit komunal, pra dhe si rezultat i negociatave të vazhdueshme me Ministrinë e Financave për shpërndarjen e mjeteve, ku një prej tyre ka qenë edhe çështja e grantit për kryeqytetin, sepse e dimë që është hera e parë që Prishtina ka grant.

Kryetari, Shpend Ahmeti, tha se ashtu siç e kërkon ligji, i kemi dorëzuar më 1 shtator, si ekzekutiv, të cilin na e ka dorëzuar Ministria me qarkoren e dytë buxhetore, ku parashihet buxheti prej 76 milionë euro. Në ndërkohë ka kaluar Ligji për kryeqytetin dhe si rezultat i ligjit ndahet 6% e grantit të përgjithshëm si buxhet shtesë, vlera prej 10.8 milionë euro, të cilën e kemi negociuar me Ministrinë, sepse kemi të bëjmë me kufij buxhetor. Menjëherë pasi e kemi marr këtë e kemi dorëzuar tek anëtarët e Kuvendit.

Eman Rrahmani tha se ne kërkojmë që pika e tretë e rendit të ditës, do të thotë pika për buxhetin dhe kornizën afatmesme, të shtyhet për së paku një muaj dhe të organizohen dëgjime publike me qytetarë. Nuk është organizuar asnjë tubim me qytetarë, në asnjë lagje dhe në asnjë fshat të Prishtinës, andaj ne këtë buxhet nuk do ta votojmë sot. Te korniza afatmesme e buxhetit vërehet qartë se nuk ka pasur asnjë punë, asnjë angazhim për të parashikuar këtë shpërndarje.

Agim Gashi tha se ajo që është elementare për ta sqaruar këtu, është se po të ishte thirrur mbledhje urgjente, do ta kishim arsyetuar disi relacionin dyditor në mes të mbledhjes së KPF-së dhe Kuvendit, sepse ajo lejohet, ndërsa mospërfillja e afatit tregon një shkelje të dispozitave që e rregullojnë këtë fushë. Udhëzimi administrativ e sqaron shumë mirë, se ftesat për mbledhje bëhen shtatë ditë përpara, dhe kjo nënkupton që fillimisht mbahet mbledhja e KPF-së, pastaj dërgohen ftesat për Kuvend shtatë ditë përpara, që nënkupton periudha kohore në mes KPF-së dhe Kuvendit është shtatë ditë, dhe nuk ka pasur nevojë me sqaruar më tutje. Pavarësisht se si e interpreton dikush sqarimin e Ministrisë së Pushtetit Lokal, kjo është shkelje e dispozitës.

Prandaj, shtyrja për një periudhë të shkurtër të kësaj pike të rendit të ditës ku është buxheti, me të vërtetë do të krijonte mundësi që secili këshilltar, qoftë edhe bashkërisht, ta analizojmë dhe të japim kontributin tonë që të dalë një projekt i propozuar me sa më pak gabime dhe sa më i saktë. Pra, ky është qëllimi, e nuk është qëllimi me shantazhuar.

Egzon Azemi tha se është e pakuptimtë pse p.sh. dy muaj nuk mbajmë mbledhje, e në gusht i mbajmë për dy ditë dy mbledhje të rëndësishme, që nuk janë hiq produktive.

Tash prapë pritet, në një moment tepër shpejtë të thirret mbledhja e KPF-së edhe seanca, në mënyrë që edhe asamblistët me qenë të papërgatitur, por nuk po e kuptoj pse është nevoja me vepruar në këtë mënyrë Komuna e Prishtinës!

I gjithë ky sulm që po ndodhë në Komunën e Prishtinës ndaj njerëzve të caktuar, për shkak të bindjeve politike, është duke u bërë me urdhrin e Shpendit, që është duke luajtur me varfërinë e njerëzve, duke luajtur me ndjenjat e tyre.

Pas diskutimeve për rendin e ditës, kryesuesi e hodhi në votim rendin e ditës.

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, 16 kundër dhe 2 abstenime, u miratua ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
2. Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2019 dhe Korniza afatmesme buxhetore për periudhën 2019-2021 (KAB);
3. Propozimvendimi për miratimin e tejkalimit të të hyrave vetanake dhe bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2017 në vitin 2018;
4. Pyetje dhe përgjigje;
5. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratim i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Eman Rrahmani bëri vërejtje në ekstrakt, duke thënë se në ekstrakt nuk është shkruar fjala e kryetarit, kur na drejtohet me fjalën "mshelë", andaj kishim pasur dëshirë që të shkruhet ashtu siç është folur.

Fiknete Bejta tha se diskutimeve të mia po u humbet kuptimi, pasi që nuk po shkruhen ashtu si po them, andaj kërkoj që të shkruhet ashtu si thuhet.

Shefki Gashi theksoi se materialet që po na dërgohen duhet të jenë më të lexueshme, dhe për më qenë më të lexueshme të printohen me ngjyra.

Halim Halimi tha se sot është mbledhja e tetë, por mungon ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së shtatë, të cilin është dashtë që sot ta kemi para vetes për miratim.

Kryesuesi tha se kjo është edhe si pasojë e mungesës së lektorëve, sepse një lektor merret me lekturimin e të gjitha materialeve të Komunës, andaj dhe është problematike të përgatiten materialet me kohë.

Kryesuesi konstatoi se më 33 vota për, 5 kundër dhe 5 abstenime, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të Kuvendit të Komunës.

Pika e dytë

Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2019, dhe Korniza afatmesme buxhetore për periudhën 2019-2021 (KAB).

Kryesuesi hapi diskutimin.

Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, tha se në bazë të Ligjit për Prishtinën, buxheti për vitin 2019 do të jetë 87.733.825 euro. Këto mjete janë të ndara në pesë kategori: paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, shpenzimet komunale, subvencioneve dhe investime kapitale. Këto mjete janë të ndara sipas tavanëve, të cilat i ka caktuar Ministria e Financave. Përveç shpenzimeve, Ministria e Financave ka bërë ndarjen dhe caktimin e tavanëve edhe për të hyrat e Komunës, prej të cilave në disa të hyra të Komunës veç janë caktuara tavanet, kurse pjesa tjetër është për taksat tjera të mbledhura.

Agim Gashi theksoi se Korniza afatmesme buxhetore 2019-2021, pjesa e vitit 2019, nuk përputhet me buxhetin, përkatësisht pasqyrat buxhetore që sot na janë prezantuar këtu, dhe këto janë vlera që ne në fund i votojmë. Kur është përgatitur pasqyra buxhetore për vitin 2019, është dashur të përgatitet edhe kopja tjetër e kornizës buxhetore, në mënyrë që dokumenti të silllet në Kuvend i përputhshëm.

Ne si GP nuk kemi pasur kohë ta analizojmë rrjedhshëm këtë buxhet. Në pasqyrat buxhetore për vitin 2019, mungojnë diku 4-5 projekte, që janë jetike për Komunën e Prishtinës. Prishtina që 4-5 vjet e ka të gatshëm projektin për ndërtimi e deponisë për mbeturinat inerte dhe ai projekt nuk po realizohet. Pra, do të ishte mirë që së paku brenda këtij mandati të parashihet një gjë e tillë, që ta dimë se ai problem do të zgjidhet njëherë e përgjithmonë, që është kategori ligjore. Kanalizimi në fshatin Llukar, prej Fshatit Grashticë ka mundur shumë thjesht me u inkorporuar dhe me u zgjidhur edhe ai problem. Rruga "A" dhe kolektorët nën rrugën "A", asnjë metër nuk parashihet deri në vitin 2021. Po ashtu, mungojnë edhe shumë projekte të tjera, të cilat është dashur të parashihen në këtë buxhet, si p.sh. rruga Busi- Marec, e cila do të duhej të shtrohej me asfalt etj.

Egzon Azemi u shpreh se nga ajo që u diskua nga parafolësi, vetë ekzekutivi do të duhej ta hiqte këtë propozim nga rendi i ditës, ashtu siç u kërkua në fillim, dhe kjo të shtyhet për një seancë tjetër dhe të bëhen edhe disa diskutime publik me qytetarët në lagjet e tyre.

Ai kërkoi nga anëtarët e Kuvendit që mos ta votojnë këtë buxhet, sepse ky buxhet nuk i plotëson nevojat e qytetarit.

Eman Rrahmani tha se ky buxhet nuk është planifikuar mirë, sepse nuk ka të bëjë fare me interesat e qytetarëve. Ky buxhet nuk ka të bëjë fare me 100 pikëshin e propozuar nga kryetari gjatë fushatës, dhe sot e ka paraqitur një projektbuxhet i cili nuk përkon me asnjë pikë prej 100 pikëshit për të cilin kemi punuar. Me këtë projektbuxhet nuk është paraparë asnjë projekt për vitin 2019 për lagjen "Kodra e Trimave", pra kryetari e ka refuzuar kërkesën e Drejtorisë së Kulturës për bibliotekë në lagjen "Kodra e Trimave", nuk e ka futur në projekt. Po ashtu, edhe shumë projekte të tjera të premtuara nuk janë realizuar.

Valbona Makolli tha se sa i përket Kornizës afatmesme buxhetore, jemi bazuar në atë që prioritetet të cilat i kanë dërguar drejtorët, janë vetëm ato të vitit 2019, mirëpo të vitet 2020 dhe 2021 prapë kanë me u ndryshuar këto shuma.

Fiknete Bejta tha se ky projektbuxhet nuk përkon me 100 premtimet e kryetarit, të prezantuar në fushatën e vitit 2017. Kam vërejtur që ka rritje të shpenzimeve në mallra dhe shërbime, si dhe në paga dhe mëditje, si dhe zvogëlim të investimeve kapitale në përgjithësi. Në këtë projekt prioritet me buxhet i është dhënë mbulimit të shpenzimeve që dukshëm janë rritur, si p.sh. shpenzimet e udhëtimit, për derivate ka rritje substanciale, për shpenzimet e marketingut gjithashtu ka rritje, etj.

Vlen të theksohet te Drejtoria e Administratës, shpenzimet kapitale, projektet janë bartur nga viti 2017, dhe tabela është identike me atë të vitit paraprak.

Po ashtu, shumë projekte nuk janë publikuar, si procedura të prokurimit etj., pra tash në këtë vit veç i kemi bartjet e tyre. Kërkoj që në buxhet të specifikohen emër për emër lagjet ku kanë me u realizuar ato projekte. Mungesa e qytetarëve në dëgjimet publike dhe në debate, ka qenë edhe për shkak të mos informimit me kohë dhe mbajtjes në orar të papërshtatshme për ta, andaj ky buxhet mund të quhet buxhet i këshilltarëve, apo i zyrtarëve të Komunës, dhe jo i qytetarëve, pasi që nuk shpërfaq nevojat dhe kërkesat e qytetarit.

Meqenëse disa kërkesa të qytetarëve të anës së Gollakut janë përfshirë në këtë buxhet, e deklaroj votën pro këtij projektbuxheti.

Sami Boroci tha se ky është buxheti më i madh që Komuna e Prishtinës e ka pasur ndonjëherë, veçanërisht për Ligjin e Prishtinës, ku tash kemi një buxhet prej 87 milionë euro, që mendoj se është një buxhet goxha ambicioz dhe një buxhet që qytetarit të Prishtinës në këtë periudhë mund t'i sigurojë një perspektivë pak më të mirë. Te investimet kapitale, Komuna e Prishtinës ka hapësirë me investuar më shumë, ose me ndarë buxhet më shumë. Një prej pikave që kemi biseduar edhe për buxhetin e vitit 2018, ka qenë ndërtimi i kolektorit, prej Pallatit të Drejtësisë, që shkon nga objekti "Koha ditore" dhe që nuk është buxhetuar as atëherë. Kjo zonë, ose kjo pjesë e cila po rritet dhe po zhvillohet jashtëzakonisht shpejt, ka nevojë urgjente për ndërtimin e një kolektori të tillë. Po ashtu, kërkoj të dijë se kur fillon dhe në cilat faza ka me u zhvilluar projekti lidhur me realizimin e rrugës "A". Sa i përket buxhetit që është paraparë për Drejtorinë e Parqeve, mendoj se e ka një buxhet të mirë. Unë më herët

kamë kërkuar që kjo drejtori të quhet Drejtori e Ambientit dhe e Parqeve, sepse ambienti duhet trajtuar në një fokus pak më të madh.
Si AKR do ta mbështesim miratimin e këtij buxheti.

Shefki Gashi tha se ndarja e buxhetit, sidomos për vitin 2019, nuk është proporcionale, nuk është e shtrirë në mënyrë të barabartë nëpër të gjitha vendbanimet e qytetit, gjegjësisht komunën e Prishtinës. Ka vendbanime që nuk përmenden fare, nuk preken fare, sikur ato familje nuk kanë kurrfarë nevoje, kurrfarë projekti, kurrfarë plani, pra kjo ndarje e buxhetit nuk po bëhet në mënyrë proporcionale, p.sh. buxheti i paraparë për Drejtorinë e Parqeve dallon dukshëm me buxhetin e Drejtorisë së Bujqësisë. Po ashtu, është hequr nga projekti rregullimi i kanalizimit në fshatin Llukar, është premtuar rregullimi i rrugës për në Lagjen e Kullecëve, rregullimi dhe renovimi i disa rrugëve në qytet, ndërtimi i shkollave etj., projekte të cilat nuk u realizuan. Një projekt i rëndësisë së veçantë për furnizim me ujë për zonën e Gollakut, që për atë projekt që 5 vjet janë ndarë mjetet në këtë asamble, me këtë kryetar komune, dhe ky projekt nuk është realizuar.

Leonora Shabani-Bajraktari tha se sa i përket planifikimit, është shumë shqetësuese se përmes buxhetit të Komunës nuk është planifikuar ndërtimi i asnjë shkolle, e kjo gjë është jashtëzakonisht e rëndë, sidomos për prindërit, por edhe për fëmijët tanë dhe të ardhmen tonë. Në këto dy pasqyrat që i kemi, d.m.th. nuk ka ndonjë ndërtim të shkollave, sidomos ato fillore. Gjithashtu, në vitin 2018 përveç për shkollën "Elena Gjika", që jemi të gjithë në njohuri, por në asnjë shkollë Komuna e Prishtinës nuk bën gëlqerosje. Po ashtu, vendosja e kamerave të sigurisë, nuk e di në cilat shkolla, se në disa shkolla fillore nuk kanë kamera të sigurisë. Ne duhet të jemi shumë të sinqertë dhe të ofrojmë sa më shumë siguri për fëmijët tanë, gjë që deri tash nuk e kemi bërë.

Leutrim Retkoceri tha se në lexim të parë ky buxhet e ka një përmbajtje, mirëpo ka nevojë për plotësim, ka hapësira të cilat do të mund të mbuloreshin edhe më mirë. Ky buxhet nuk i ka në fokus investimet kapitale, apo projektet madhore të cilat i duhen Prishtinës, më konkretisht të arsimit, ku nuk janë mjete të mjaftueshme prej 600 mijë euro për çerdhe dhe për kategori të tjera të arsimit.

Ne e mbështesim Ministrinë e Financave, e cila ka kërkuar që buxheti që vjen prej grantit shtesë, të fokusohet më shumë në investime kapitale. Mjetet prej 10.8 milionë euro, janë shumë të rëndësishme që të fokusohen më shumë në investime kapitale, pavarësisht tavaneve që i kanë caktuar, pra të fokusohemi më shumë se Prishtina ka nevojë për investime kapitale, ka nevojë për më shumë rrugë, për më shumë parqe, ka nevojë për parkingje etj.

Naime Osmani bëri vërejtje kryesisht rreth menaxhimit të këtij projektbuxheti, duke thënë se ekzekutivi i Komunës së Prishtinës duhet me e bërë menaxhimin si duhet, në bazë të pozitës strategjike të lagjeve, të fshatrave, ku secila është e rëndësisë së veçantë, dhe mos të përfshihet asnjë projekt askund, asnjë fshat i pjesës veriore të Prishtinës, kjo është me të

vërtetë shumë keq. Bardhoshi është paralagje e Prishtinës, çka është realizuar aty?! Pra, këto gjëra duhet t'i keni parasysh. Këtë projekt buxhet kështu pa specifikimin e projekteve, nuk do ta votoj.

Milazim Vitija shprehu shqetësimin e tij për mungesën e bashkëpunimit me kryetarët e bashkësive lokale. Kryetarët e bashkësive lokale vazhdimisht bëjnë kërkesa dhe i bëjnë specifikat e veta në bazë të prioriteteve që i marrin nëpër bashkësitë e tyre lokale, së bashku me këshillin e tyre. U bënë pesë vjet që në pjesën rurale ndërtohen rrugët e militantëve e jo rrugët që bëhen në bazë të kërkesave të bashkësive lokale. Andaj, do të ishte mirë, edhe vazhdimisht e kemi potencuar, që t'u krijojmë kushte atyre banorëve që janë duke jetuar atje, si p.sh. është më se i nevojshëm ndërtimi i rrugës në Lagjen e Borocëve dhe rrugë të tjera në këtë zonë. Po ashtu, mungon ujësjellësi në ambulancë në Viti dhe Bullaj. Ai kërkoi nga Drejtoria e Bujqësisë, që vaksinimi i bagëtitive të bëhet në muajin mars e jo në korrik, si ka ndodhur në këtë vit.

Për vërejtjet dhe sugjerimet e ngritura nga parafolësit lidhur me projektbuxhetin për vitin 2019, Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, dha sqarime të nevojshme.

Gëzim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, tha se sa i përket projektit për rregullimin e rrugës në Lagjen e Borocëve, duhet t'i shtohet edhe rregullimi i rrugës për në lagjen "Bilalli".

Halim Halimi tha se po ta analizojmë këtë projektbuxhet, shihet se shpenzimet e udhëtimit dhe mëditjet jashtë vendit janë në rritje. Kemi dreka zyrtare, shërbimet e telefonave, udhëtimet jashtë vendit, që iu kushtohet rëndësi, por më mirë ka qenë të fokusoheni në investimeve kapitale, sepse me të vërtetë nuk e di se çka është punuar deri tash në qytet.

Ai tha se këtë buxhet që e keni sjellë këtu për miratim, nuk meriton me u shqyrtuar, sepse është në kundërtënie buxheti me kornizën.

Vlora Dumoshi tha se Prishtina këtyre viteve ka qenë shumë e varfër me kulturë, në pjesën kulturore, por unë pres që kjo të ndryshoj, sigurisht me përpjekjet e drejtorit të Drejtorisë, Yllit, që e kam parë angazhimin e tij. Shihet se në këtë buxhet nuk është përfshirë ndërtimi i Sallës së koncerteve. Lidhur me këtë ajo kërkoi sqarim nga kryetari, se për çfarë arsye nuk është paraparë në buxhet ky projekt, sepse ka pasur mjaft zëra se kjo do të ndërtohet, edhe pse projekti ka qenë i gatshëm për prokurim.

Lidhur me çështjen e ngritur rreth ndërtimit të Sallës së koncerteve, **Shpend Ahmeti** dha sqarime të nevojshme.

Pas diskutimeve, **Kryesuesi** e hodhi në votim propozimbuxhetin e Komunës.

Kryesuesi konstatoi se më 25 vota për, 16 kundër dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për buxhetin e Komunës së Prishtinës për vitin 2019, dhe Korniza afatmesme buxhetore për periudhën 2019-2021 (KAB).

Pika e tretë

Propozimvendimi për miratimin e tejkalimit të të hyrave vetanake dhe bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2017 në vitin 2018.

Kryesuesi hapi diskutimin.

Lidhur me Propozimvendimin për miratimin e tejkalimit të të hyrave vetanake dhe bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2017 në vitin 2018, të shkurtra të pranishmit i njoftoi Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave.

Halim Halimi tha se sa i përket bartjes së buxhetit prej vitit 2017 në vitin 2018, dihet se bartja do të duhej të bëhej më herët, pra të gjitha shpenzimet që janë bërë, janë bërë pa vendim. Kjo të bënë të kuptosh se nuk bëhen planifikime të mira, d.m.th. keq planifikim, por edhe keq menaxhim, sepse është vepruar pa vendim të Kuvendit.

Leonora Shabani - Bajraktari tha se disa projekte të parapara në disa shkolla, nuk përputhen me kontratat që janë paraparë, si p.sh. instalimet e renovimet e ngrohjes qendrore. Në listën e kontratave janë dy kontrata: "Mirëmbajtja e ngrohjeve qendrore në shkollat dhe institucionet tjera komunale" dhe "Instalimi i ngrohjes qendrore në shkollën e mesme të ulët "Avni Rrustemi", shkolla fillore e mesme e ulët "Ganimete Tërbeshi", "Ditët e Minatorit" dhe "Nexhmi Mustafa" në Rimanishtë".

Fiknete Bejta tha se është praktikë e mirë nëse kalojmë në menaxhimin më të mirë të buxhetit, në mënyrë që ta kemi një menaxhim më efikas dhe më efektiv, sepse edhe të gjitha kritikant, edhe të auditorit, janë tek menaxhimi i kontratave, afati i publikimit, vlerësimi i ofertave etj. Këtu po ngec dhe pastaj si rezultat i kësaj po kemi edhe një vlerësim më të madh të kontigjencave, pastaj edhe me pagesat për përmbarues. Vetë fakti që po vonohen bartjet e buxhetit kaq shumë, d.m.th. në tre muajt e fundit, fatkeqësisht të vitit kalendarik buxhetor, na tregon që do të ketë pagesa me përmbarues.

Eman Rrahmani tha se këtu ka hapësirë për një lloj hetimi për marrjen e përgjegjësisë se qysh janë kryer pagesat e këtyre projekteve, në çfarë mënyre, se a është ligjore apo jo, sepse e di që shumica e këtyre projekteve veç janë përfunduar edhe pagesat janë përfunduar. Te investimet kapitale dhe menaxhimi i kontratave, bartja është 8 milionë e 919 mijë e 277 euro, dhe se drejtori aktual as 50% të kësaj bartje nuk e ka shfrytëzuar deri në 6-mujorin e parë, kjo do të thotë që as bartjen nuk ka me arritur me u shfrytëzuar për komplet vitin 2018. Kjo tregon një dështim total të kësaj drejtorie.

Gezim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, tha se sipas projekteve kemi ndërtimin e bulevardit mbi Kurriz, ndërtimi i stadiumit në Hajvali, i cili ka filluar në vitin 2016. Po ashtu, në këtë vit ka filluar edhe riparimi i garazheve.

Leutrim Retkoceri tha se bartja e buxhetit nga viti 2017 në këtë vit, mendoj se është një shqetësim i llojit të vetë. Në përgjithësi, të gjitha projektet dhe punët që nisin në kryeqytet, ato zgjaten edhe më shumë, mirëpo duhet të jetë një angazhim më i shtuar, në mënyrë që të përmirësohen edhe afatet e zbatimit të atyre punëve.

Vlora Dumoshi tha se bartja e mjeteve zakonisht bëhet, por është shqetësuese bartja e mjeteve tek të cilat po ndodh çdo vit për Komunën e Prishtinës. Pothuajse 50% e investimeve kapitale bëhen për çdo vit, pra shihet se është një menaxhim shumë-shumë i dobët.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna rreth realizimit të disa projekteve në Drejtorinë e Kulturës, **Ylli Rugova**, drejtor i Drejtorisë, dha sqarime të nevojshme.

Gezim Mehmeti, drejtor, tha se mosrealizimi i buxhetit varet nga planifikimi jo adekuat që është bërë në vitin 2017. Po ashtu, problemet pronësore janë shkaku kryesor i vonësive edhe mosrealizimit të projekteve.

Adrian Berisha kërkoi nga anëtarët e Kuvendit që mos të merren me të kaluarën, por sugjeroi që të fokusohemi në projekte të cilat janë për të mirën e qytetit edhe për të ardhmen.

Vala Peshku tha se këto mjete nuk janë as të Shpendit, as të partive të tjera, por këto janë paratë e taksapaguesve edhe përderisa ne mundemi me arritur votimin e një buxheti që është shumë i mirë, por pse mos me qenë edhe më i mirë vitin e ardhshëm, pra të votojmë për të mirën e qytetarit.

Pas diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim propozimvendimin.

Kryesuesi konstatoi se më 25 vota për, 2 vota kundër, u miratua Vendimi për miratimin e tejkalimit të të hyrave vetanake dhe bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2017 në vitin 2018.

Pika e katërt
Pyetje dhe përgjigje.

Leutrim Retkoceri, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave:

- Banorët afër rrugës "Aleks Buda", te rruga "Bledi", kanë bërë kërkesë për shtrimin e rrugës me asfalt. Në buxhet ishte ndarë një vijë buxhetore për një pjesë të rrugës, por nuk e di a është futur me u rregulluar në këtë vit apo jo.

- Banorët afër rrugës "Adem Gllavica", te Tregu i gjelbër, janë të shqetësuar

Për rrugën e tyre, e cila është ndërtuar pjesërisht në mandatin e qeverisjes së LDK-së, në atë pjesë ka qenë një zyrtar i LDK-së dhe rruga është shtruar vetëm deri te dera e tij, kurse pjesa tjetër ka mbetur pa asfaltuar.

Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, tha se në bashkëpunim me drejtorin e Investimeve Kapitale, te buxheti e kemi lënë një pozicion tek rindërtimi dhe rikonstruktimi i rrugëve rurale, ku drejtori, në bashkëpunim me kryetarët e bashkësive lokale, do t'i perceptojnë dhe analizojnë më në detale këto projekte.

Gëzim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, tha se në atë rrugë ka nevojë për sanime të përkohshme. Mund të bëjmë sanim të menjëhershëm, por për t'u rregulluar në tërësi mbetet për vitin e ardhshëm.

Valbona Petrovci, në cilësinë e anëtares së Komitetit për komunitete, kërkesë për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave dhe për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

- Çka është bërë me ndërtimin e fushës së futbollit dhe basketbollit në Bërnice të Poshtme, si dhe ndërtimi i trotuarit në rrugën kryesore në Bërnice të Poshtme, në njërin krah, me gjatësi 2 kilometra?
- Pse nuk po shtrohen me asfalt të gjitha rrugët dytësore në Bërnice të Poshtme, d.m.th. këto janë krejt premtime që janë bërë?
- Pse nuk po shtrohet rruga në asfalt prej kanalit të sistemit "Ibër-Lepenc" deri tek varrezat në Bardhosh, në një gjatësi 150 metra?
- Ka shumë ankesa nga radhët e komuniteteve lidhur me faturat e mbeturinave, se ajo dukuri e ardhjes së dyfishtë të faturave për një amvisëri është e tepërt. Çka është paraparë apo çka është bërë lidhur me këtë?

Gëzim Mehmeti, drejtor, tha se ne kemi planifikuar për komunitete shumë prej 95.000 eurove, të gjitha këto që ju i cekët mund të përfshihen në planifikim, sepse për afërsisht aty është kostoja e projekteve, do të thotë realizohen të gjitha.

Ismail Kokaj, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, tha se faturat e mbeturinave janë paraparë sipas Rregullores, e cila ka kaluar përmes këtij Kuvendi, në bazë të tatimit në pronë janë prerë edhe faturat. Nëse ka rast që dikush e ka një shtëpi, ka me paguar faturën deri sa nuk ndodh. Për çdo parregullsi është Komisioni i ankesave brenda Drejtorisë së Shërbimeve Publike, të cilin e ka formuar kryetari. Unë nuk mundem me e ndërruar e me dal jashtë Rregullores.

Naime Osmani, për z. Muhedin Nushi, nënkryetar i Komunës, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave:

- Qytetarët e komunës së Prishtinës kërkojnë që të ngrihet përmendorja e Anton Çetës, në vendin e merituar të qytetit, pasi që ajo e cila është te restoranti "Pishat", është mbuluar nga bërriloku dhe pluhuri dhe është në vend të papërshtatshëm. Kërkoj që ajo përmendore të ngrihet në vend meritore.
- Banorët e lagjes "Kodra e Trimave" kërkojnë që të shtohet numri i autobusëve të linjës "3" të Trafikut Urban, po ashtu të vendosen edhe stacionet e autobusëve përballë "Blerat", saktësisht nuk po e di, por e di që në rrugën "Vëllezërit Fazliu", është diku atje përtej udhëkryqit, përtej restorant "Shpeta" dhe në anën tjetër tek firma "Egzoni", d.m.th, në hyrje të qytetit.
- Banorët e fshatit Tenezhdoll kërkojnë që të shtrohen rrugët me asfalt dhe të bëhet ndriçimi i tyre, si dhe vendosjen e tabelat me emrat e rrugëve në këtë fshat.
- Banorët afër rrugës "Xhemë Tërnavci" kërkojnë që të bëhet ndriçimi i rrugës.
- Shqetësim i qytetarëve është edhe pagesa e mbeturinave, sidomos për bashkatdhetarët që jetojnë jashtë vendit. Kuptohet se shumica kanë shtëpi dhe vijnë brenda vitit ndoshta vetëm një muaj, dy javë apo tri javë, dhe ne duhet me e gjetur një mënyrë se qysh do të bëhet faturimi i mbeturinave për këtë kategori.
- Është edhe një rast lidhur me pagesat për mbeturina që është paraqitur në Lagjen "Kodra e Trimave". Një pronar ka dy objekte banimi brenda në oborr dhe aty është vetëm një familje katër anëtarësh, njëra shtëpi është e regjistruar në emër të burrit kurse tjetra në emër të gruas, d.m.th. ata katër anëtar jetojnë aty dhe paguhen dy fatura të mbeturinave. Kërkoj të dijë se si mund të rregullohet kjo çështje.

Ismail Kokaj, drejtor, tha se me ardhjen e autobusëve të rinj, do të bëhet edhe një ri programim i autobusëve, në mënyrë që të ketë mundësi për të shkuar edhe në lagjen "Kodra e Trimave". Çështjen e ndriçimit e kemi diskutuar disa herë dhe prapë është përgjigja e njëjtë.

Çdo pyetje që bëhet gojarisht apo me shkrim, përgjigjen keni me marr në mënyrë të njëjtë. Nëse është në proces, e kupton se është në proces edhe ndriçohet, por në bazë të mundësive buxhetore kemi me e bërë edhe ndriçimin publik.

Sa i përket pagesës së mbeturinave, faturimi i tyre është i paraparë me rregullore të Kuvendit dhe nëse bëhet ndryshimi i Rregullores, atëherë ne e përkrahim rregulloren me ato ndryshime që bëhen.

Kushtrim Sopa, për z. Muhedin Nushi, nënkryetar i Komunës, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave dhe për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit:

- Kërkoj që vendosja e bustit të Anton Çetës të bëhet në një vend meritore në kryeqytetin e Kosovës, në Prishtinë, karshi figurave të mëdha të kombit tonë.

- Pranë xhamisë në lagjen "Arbëria", janë vendosur rrethoja nga hekuri në një pjesë të konsiderueshme të asaj parcele-prone dhe qytetarët menjëherë kanë shprehur shqetësimin e tyre për destinimin e atij lokacioni për varreza apo çka tjetër. Shtëpitë e këtyre qytetarëve janë pothuajse të rrethuara gjithandej nga varrezat dhe qytetarët e kësaj zone nuk pranojnë që edhe një kënd tjetër të mbushet me varreza. Unë më herët kamë kërkuar që në atë hapësirë të ndërtohet një mini-park dhe kënd i lojërave për fëmijët e asaj zone.
- Kërkoj që të vendosen "policë të shtrirë" dhe shenja të komunikacionit përgjatë rrugëve "Ahmet Dërguti", "Toni Bler" dhe "Plava" në lagjen "Arbëria".
- Kërkoj që të bëhet inspektimi i shkollave fillore dhe të mesme në Prishtinë për higjienë, kushtet e mësimit dhe rendin disiplinor.
- Kërkoj që të bëhet dhe mirëmbahet ndriçimi i rrugëve "Lutfi Veliu", "7 Shtatori" etj., Në lagjen "Arbëria". Gjithashtu të bëhet riparimi emergjent i ndriçimit në parkun "Gërmia" dhe ndriçimi i lagjes "Dardania" – "Kurrizi".
- Kërkoj që të bëhet trajtimi adekuat i Varrezave të Dëshmorëve, duke bërë rregullimin e mirëfilltë të tyre me gjelbërim, vendosje të ulëseve dhe ndarjen e lokacioneve adekuate për njërën prej kategorive më të rëndësishme të shoqërisë dhe kombit tonë.
- Kërkoj që të bëhet intervenim urgjent në lagjen "Mati 1", rruga "Ndue Përllëshi", rrugë kjo e cila është e dëmtuar dhe amortizuar shumë, ku qytetarët hasin në vështirësi të qarkullimit normal. Gjithashtu, në lagjen "Mati 1" kërkohet trajtim i veçantë i mbeturinave, ngase kjo lagje veçse është mbipopulluar, ku fillimisht qytetarët po hasin në mungesë të kontejnerëve dhe pastaj pastrimit adekuat të mbeturinave.
- Kërkoj që të bëhet trajtimi i qenve endacakë në të gjitha lagjet e Prishtinës, me theks të veçantë lagjet të cilat kanë parqe dhe janë afër zonave malore.

Mbledhja përfundoi në orën 13:12.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi



Kryesuesi i Kuvendit
Agim Kuleta